



BASHKIA SKRAPAR

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje nafte për administratën, për ujitje - kullimi dhe për zjarrfikësen për vitin 2026”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09134000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 499 866 (dymilion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore të për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në piken 2c, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e percaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të percaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”*

- b) Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2025.

Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2023. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4.

2.3 Kapaciteti teknik:

- a) Dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit që prokurohet. Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme :
- Për kontrata me institucionet shtetërore për përvojën e mëparshme duhet të paraqiten vërtetime realizimi të lëshuara nga institucionet perkatese me të cilat keni realizuar kontratën, ku shënohen datat, shumat, sasite dhe shërbimet e realizuara.
 - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të firmosura e të konfirmuara nga bleresi dhe shitesi ku të percaktohen qarte, datat, shumat, sasite dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 4b, e nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- c) Subjektet ofertuese pjesëmarrëse duhet të jenë të licensuar në fushën e tregtimit të karburanteve (Naftë D1) lëshuar nga institucionet përkatëse. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesin lejen përkatëse.

Argumentimi: Në bazë të pikës 2, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në nenin 4 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, në VKM-në nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të pajisur me leje të tregtimit të karburantit.

- d) Subjektet pjesëmarrës në tender të kenë të punësuar të pakten 3 (tre) punonjës të siguruar për periudhën Janar 2025 – Dhjetor 2025 (Lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve së bashku me listëpagesat sipas formularit). Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- *Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për vitin 2025.*
- *Listëpagesat (E-Sig 025) të vulosura nga Administrata Tatimore*

Argumentimi: Në bazë të pikës 1, 4 dhe 5 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqinë punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2025.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 dhe 5 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 7 dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2022.

Vendosja e këtij kriteri është bërë duke pasur në konsideratë parshikimet ligjore të ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, ligji nr.32/ 2016 datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve/instalimeve nën presion” si dhe VKM nr.212, datë 16.03.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm

të naftës (GLN)” dhe ligji nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, i ndryshuar.

- f) Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në qytetin e Skraparit, nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj në zbatim të VKM-së Nr. 561, datë 29.7.2016 i ndryshuar, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 7 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se mundësojnë ofrimin e shërbimit me kartë elektronike.

- g) Operatori Ekonomik duhet të disponojnë në pronësi ose me qera një ose më shumë pika tregëtimi karburanti brenda territorit të Bashkisë Skrapar. Për të provuar kriterin e mësipërm OE duhet të paraqesë Çertifikata/Vërtetim Pronësie ose kontratë qiraje / vërtetim për vendin e ushtrimit të aktivitetit sipas QKB.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 dhe 5, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë një pikë të furnizimit me karburant në pronësi ose qira/ kontratë bashkëpunimi, brenda territorit të Bashkisë Skrapar.

Ky kriter është vendosur për të provuar disponueshmërinë e pikës së karburantit nga operatori ekonomik dhe për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, nëse operatori shpallet fitues. Përcaktimi i vendndodhjes brenda territorit të Bashkisë Skrapar është vendosur për të bërë të mundur furnizimin e vazhdueshëm dhe periodik të mjeteve të institucionit pa kosto ekstra në karburant dhe burime njerëzore.

- h) Subjekti duhet detyrimisht të paraqesë në tender një fletë analizë të lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator i çertifikuar në Republikën e Shqipërisë. Fletë analiza duhet të jetë lëshuar brenda 3 (tre) muajve nga data e hapjes së tenderit. Gjithashtu operatori fitues duhet të dorëzojë fletë analize të lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator i çertifikuar në Republikën e Shqipërisë, çdo 3 (tre) muaj pranë Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane të testimeve zyrtare pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

- i) Operatori ekonomik duhet të disponojë çertifikatatë ISO 9001:2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalentin e saj.

Shënim: Çertifikatat e mësiperme/ekuivalente duhet të jenë të lëshuar nga Institucione të çertifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombëtare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këto certifikata në perputhje me shërbimet që ka marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë.

- j) Subjektet pjesëmarrëse në tender duhet të jenë të pajisur me Leje Mjedisore për pikë shitje karburanti.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Të dhënat teknike të Gazoil (blu-dizel 10 ppm) i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH): Karburant dizel (Gazoil) sipas S SH EN 590:2022 ose ekuivalent

Nr	Emërtimi	Njësia	Kufijtë e lejuar		Metoda e provës
			Min	Max	
1	Numri cetanit		51	-	EN ISO 5165
2	Indeksi i cetanit		46.0	-	EN ISO 4264
3	Densiteti ne 15 C	kg/m ³	820	845	EN ISO 3675 EN ISO 12185
4	Hidrokarbure policiklik aromatik	% (m/m)	-	8.0	EN 12916
5	Permbajtja e squfurit	mg/kg	-	10.0	EN ISO 20846 EN ISO 20847 EN ISO 20884
6	Pika e flakerimit	oC	oC Mbi 55	-	EN ISO 2719
7	Mbetje karbon	% (m/m)	-	0.30	EN ISO 10370
8	Permbajtja e hirit	% (m/m)	-	0.01	EN ISO 6245
9	Prembajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937

10	Ndotja e pergjithshme	mg/kg	-	24	EN 12662
11	Korrozioni il shufres se bakrit (3 ore ne 50 ⁰ C)	Vleresuar	Klasa 1		EN ISO 2160
12	Stabiliteti i oksidimit	g/m3	-	25	EN ISO 12205
13	Vetitë lubrifikuese, diametri i korrektuar i njollës së gripuar (gërryer) (ësd 1,4) në 60 °C	µm	-	460	EN ISO 12156-1
14	Viskoziteti ne 40 oC	mm2/s	2.00	4.50	EN ISO 3104
15	Destilimi % (VN) ne 250 ⁰ C % (VN) ne 350 ⁰ C 95 % (VN)	% (VN) % (VN) oC			EN ISO 3405
				0<65	
			85		
				360	

Ndërsa çmimi për njësi është marrë nga INSTAT për muajin e fundit ose Dhjetor 2024.

NJËSIA E PROKURIMIT

Benis Dosti

Arbëri Lame

Jona Koçi